



Duke u mbështetur në nenin 40 paragrafi 2 nënparagrafi I), nenit 17 paragrafi 1 nën b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 17 të Ligjit për Planifikimin hapësinor Nr.04/L-174, ish Vendimit për hartimin e Planit rregullues-detal urban, të Kuvendit Komunal të datës 05.05.2010 me 01 nr.350-1532/10, Vendimit për Planin Zhvillimor Komunal të dt.26.11.2015 me 01Nr.06-5941/2015, Vendimit për Pëlqim Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Rregullues Urban të Qytetit të Klinës Nr.14/4648/1-ZSP/215/14 datë:17.10.2014 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Raportit lidhur me Takimin me Publikun të datës 27 maji 2014 nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në bashkëpunim me Komandin hartuese të Planit Urban Plus-Prishtinë, Rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 13.11.2015 si dhe rekomandimeve të Komisionit ndërmjësor MMPH/MAPL të dt.13.01.2016 Nr.0204-1812/13 –për rishqyrtim të Vendimit të dt.26.11.2015, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-re të rregullt për vitin 2016, të mbajtur më 29.01.2016, mori këtë:

## V E N D I M

Për

### Miratim të Planit Rregullues i Hollësishëm i Klinës

I

Miratohet Plani Rregullues i Hollësishëm i Klinës.

II

Plani Rregullues i Hollësishëm si në pikën 1 të këtij vendimi është miratuar për periudhën 8 (tetëvjeçare) ndërsa i njëjti mund të ndryshohet sipas periudhës kohore që parasheh Ligji për Planifikimin Hapësinor Nr.04/L-174, në nenin 17 paragrafi 8 .

III

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është teksti formal i Planit, hartografia të paraqitura si kopje fizike dhe në CD-në adekuate.

IV

Vendimi është i plotfuqishëm me miratim nga Kuvendi i Komunës dhe 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës konform nenit 18 paragrafi 1 të Rregullores, Nr.01/2013, për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunave.

V

Me këtë vendim të njoftohen : MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe MM, Zyra për Informim, një kopje për dosje dhe një për Arkivin e Komunës Klinë.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-346 2016  
Klinë, me 29.01.2016



Kryesuesi,  
Dr. Haxhi Ibishi